



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 04 , Datë 04 / 04 /2025

“Për shtyrjen e afatit eë procesit të vetëkandidimit në kuadër të ngritjes së Komisioneve të Zgjedhjeve në njësitë përbërëse të UT-së”

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme në Universitetin e Tiranës”, Kreu II, neni 7; vendimit, nr. 2, datë 27.03.2025, të KIZ, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të periudhës së vetëkandidimit për anëtarë të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, në Universitetin e Tiranës.
2. Regjistrimi i kandidatëve për këto komisione, fillon në datën 07 prill 2025 dhe përfundon në datën 09 prill 2025, nga ora 08.00 – 16.00. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Vendimi dërgohet për njohje dhe zbatim në të gjitha fakultetet, Institutin e Fizikës Bërthamore dhe Filialin e Sarandës, të UT-së.



4. Vendimi publikohet në mjediset e fakulteteve; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, të UT-së dhe në faqet e tyre zyrtare.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|---|
| 1. Migena Buka | (Kryetar) |  |
| 2. Arbër Qoshja | (Anëtar) |  |
| 3. Edlira Çaro Kola | - // - |  |
| 4. Enkelejda Koka | - // - |  |
| 5. Kristian Kina | - // - | (në mungesë) |
| 6. Manjola Nasi | - // - |  |
| 7. Krenar Goxhaj | - // - |  |

